



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I64-16 Prot.

Tiranë 17/12/2025

Nr. Dok. 202503366/

Lënda: Rekomandohet zbatimi efektiv i "Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Urdhrit të Psikologut me shkresën nr. 4 Prot, datë 08.01.2024, në të cilën është përditësuar lista e psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerëve të policisë.

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Tiranë

Urdhrit të Psikologut

Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka nisur me iniciativë një hetim administrativ lidhur me praninë e psikologut asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerit të Policisë.

Gjatë vitit 2025, janë kryer 35 inspektime në shërbimet policore, mbi mënyrën e trajtimit të rasteve të shoqërimit të shtetasve, veçanërisht rolin dhe praninë e psikologut në polici lidhur me trajtimin e personave të mitur.

- Nga këto inspektime ka rezultuar **se mungon afishimi i listës njohëse me psikologët asistues të përcaktuar nga Urdhri i Psikologut.**
- Në disa raste është evidentuar mungesa e pranisë së psikologut në komisariat përgjatë intervistimit të të miturve. Në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore kemi konstatuar përgjatë inspektimeve se kanë shoqëruar të mitur në

konflikt me ligjin, të shoqëruar nga prindërit por pa praninë e avokatit mbrojtjes dhe psikologut¹.

- **Është konstatuar mungesa e dhënies së kartës së të drejtave në formë shkresore**, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarjat. Rekomandimi i MKPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet t'u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj. Aktualisht, karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluar/arrestuari merret në pyetje nga OPGJ dhe hyn në dhomat e sigurisë. Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *"Kartën e të drejtave"* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarjat policie. Nëpërmjet *"Kartës së të drejtave"* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij. *"Karta e të Drejtave"* i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë. Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të *"Kartës së të Drejtave"* është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Kjo praktikë është vlerësuar edhe Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues CPT-ja, i cili e përshëndeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit duhet të shkruajnë e lexojnë dhe e kuptojnë përmbajtjen e kartës.
- **Gjithashtu është evidentuar se ka mangësi në plotësimin e dokumentacionit** me saktësi dhe korrektësi, sipas detyrimeve ligjore dhe në këto raste shpesh herë mungon siglimi i psikologut të pranishëm përgjatë intervistimit në regjistrin për të miturit në konflikt me ligjin. Sikurse përcaktohet dhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*. a.4 Regjistri i Evidentimit të Dhënave për Personat e Shoqëruar të Mitur (14 – 18 vjeç)
 - a.4.1 *"Në këtë regjistër hidhen dhe administrohen të dhënat për rastet e shoqërimit të personave të mitur (të mitur në konflikt me ligjin, të dëmtuar dhe dëshmitarë) të moshës nga 14 – 18 vjeç, sipas rubrikave të parashikuara*

¹ RekomandimK4/I29-2, Prot. Datë 27.08.2025.

regjistrin tip dhe “model 4”, bashkëlidhur dhe pjesë e kësaj procedure standarde.

a.4.2 Të dhënat që evidentohen dhe administrohen për personat e shoqëruar të mitur, janë si vijon:

- a. Emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja.*
- b. Adresa e saktë e vendbanimit.*
- c. Arsimi dhe shkolla që frekuenton i mituri;*
- d. Pamja e jashtme e personit duke përfshirë dhe shenja të veçanta që mund të kenë (me një dorë apo një sy, shenja djegieje apo plage, tatuazhe, nishane etj)*
- e. Arsytet e shkaqet e shoqërimit.*
- f. Ora, data e shoqërimit.*
- g. Vendi/zyra ku është shoqëruar i mituri.*
- h. Të dhëna për punonjësën e policisë që ka kryer shoqërimin.*
- i. Të dhëna për njoftimin e prindit, kujdestarit, mbrojtësit ligjor (emër, atësi dhe mbiemër; numri i telefonit dhe ora e njoftimit).*
- j. Të dhënat për personat e pranishëm (prindi, kujdestari, mbrojtësi ligjor, psikologu)*
- k. Punonjësi i policisë që punoi me të shoqëruarin dhe vendi, (zyra ku kryhen veprimet)*
- l. Ora e kryerjes së intervistimit të të miturit;*
- m. Ora dhe data e lënies së lirë të personit.*
- n. Nënshkrimi i personit që ka qenë i pranishëm gjatë intervistës.*
- o. Pretendime nga i shoqëruari dhe nënshkrimi i tij.*

a.4.3 Pasqyrimi i dhënave sipas rubrikave të parashikuara në regjistër, bëhet në mënyrë të kuptueshme me shkrim të pastër dhe të lexueshëm, pa gabime, korrigjime apo fshirje”.

- **Mungesa e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur**, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit. Nga inspektimet është konstatuar se intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e komisariateve, kryhet në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde². Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

² Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

Sjellim në vëmendje se i mituri në konflikt me ligjin, viktimë dhe/apo dëshmitar, gëzon të drejtat e parashikuara, jo vetëm në Kodin e Procedurës Penale, por edhe të drejtat e 1 Pika 3, e nenit 52, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, parashikon se: “grupi teknik ndër sektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë”. Kështu, në rastet e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të të miturit dhe shoqërimit të tij në komisariate, detyrimisht njoftohet familja, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, psikologu, etj. Në çastin e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, të miturve u bëhet i qartë shkaku i kufizimit të lirisë dhe u komunikohen të drejtat dhe garancitë procedurale. Të miturit merren në pyetje nga specialistë të Policisë së Shtetit, pasi janë njoftuar prindërit apo përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, si dhe psikologu, që do të thotë, se pyetja e të miturit (sidomos atyre nën 14 vjeç), mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij. Sikundër, sjellim në vëmendje, se asnjë i ndaluar nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit/dënimit mizor, çnjerëzor poshtërues, ose ndonjë forme dhune ose kërcënimi dhe sidomos në rastet e të miturve kjo është thelbësore.

Sipas nenit 40 të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve³ “Shteti i njeh çdo fëmijë të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.”

Ndërkaq sërish në këtë nen, në paragrafin e dytë të tij, shpjegohet qartë se si duhet të jetë procesi juridik i shoqërimit dhe intervistimit të një mituri në organet e policisë. Saktësisht ky paragraf përcakton se i mituri duhet të prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet pafajësia e tij ligjërisht; të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij; si dhe të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.

Gjithashtu referuar gjetjeve të Mekanizmit Kombëtar nëpërmjet inspektimeve periodike të kryera për vitin 2025 dhe problematikat e konstatuara lidhur me praninë e psikologut asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerit të Policisë, Mekanizmi Kombëtar i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive

³ <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

Vendore të Policisë nëpërmjet shkresës K4/I64-2 Prot, datë 01.09.2025 “*Kërkohej informacion lidhur me praninë e psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerëve të policisë*”. nëse: A ka gjetur zbatim marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Urdhrit të Psikologut me shkresën nr. 4 Prot, datë 08.01.2024, në të cilën është përditësuar lista e psikologëve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga ana e oficerëve të policisë? A kanë qenë prezentë gjatë procesit të intervistimit të të miturve në komisarate, psikologët sipas listës emërore të miratuar nga Urdhri i Psikologut sipas Drejtorive Vendore të Policisë së Shtetit ?

Me shkresën nr.4349/1 Prot. datë 12.09.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na bën me dije se: Në rastet e trajtimit me të mitur, punonjësit e policisë kontaktojnë psikologët e DVP-ve ose OJF-ve. Në të gjitha drejtoritë vendore të policisë është parashikuar si funksion organik pozicioni “specialist psikolog” dhe janë caktuar gjithsej 16 të tillë, të ndarë sipas dinamikës së qarqeve. Në përshkrimin e punës të këtij funksioni është parashikuar edhe asistimi në rastet e trajtimit të të miturve që janë në konflikt me ligjin, si autorë, viktimë/dëshmitarë të veprave penale, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Strategjinë Ndersektoriale për të Mitur 2023-2026. Lista emërore e dërguar nga urdhri i psikologut, jo gjithmonë i është përgjigjur strukturave të Policisë së Shtetit. Përsa i përket numrit të psikologëve të cilët kanë qenë aktiv nga Urdhri i Psikologut, sqarojnë se me gjithë komunikimin e vazhdueshëm të strukturave qendrore dhe vendore të policisë me Urdhrin e Psikologut, për përditësimin e kësaj liste ende nuk ka ndodhur. Nga lista e psikologëve të vënë në dispozicion:

- shpesh nuk i përgjigjen thirrjeve të policisë,
- disa prej tyre nuk janë aktiv për dhënien e shërbimit,
- kanë shpërndarje të limituar sipas njësive të qeverisjes vendore/bashkive dhe në disa prej tyre mungon plotësisht shërbimi.

Në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Urdhrit të Psikologut me shkresën nr. 4 Prot, datë 08.01.2024, palët zotohen në shkëmbimin e përvojave dhe të praktikave të mira në organizimin e punës së psikologëve, kryerjen e funksioneve të tyre, realizimin e proceseve të trajnimit dhe vendosjen e metodologjisë së trajnimeve; Angazhimin e palëve në raste konkrete sipas kërkesave të rastit; Organizimin e konferencave, seminareve, leksioneve dhe takimeve të ndryshme në përputhje me interesin e përbashkët të palëve duke krijuar programe dhe kurrikulave të reja për psikologët; Zhvillimi dhe bashkëpunimi dypalësh përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta arsimore dhe shkencore, si dhe aplikime për projekte, si dhe çdo palë do të jetë përgjegjëse për përbashkimin e kostove të veta të cilat burojnë nga bashkëpunimi i realizuar përveçse kur është rënë dakord mes palëve ndryshe me shkrim.

Avokati i Popullit lidhur me problematikat e konstatuara sa më lart evidenton se në nenin 18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM). “Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut”, të këtij Kodi, parashikohet se:

“1. Në çdo fazë të procedimit penal me të mitur në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme.

2. Psikologu garanton, sipas rastit, mbështetjen psikologjike të të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor.

3. Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.

4. Organet kompetente, sipas rastit dhe nëse kjo është e mundur, kujdesen që të sigurojnë praninë e të njëjtit psikolog gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale për miturit dhe vetëm nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit.

5. Psikologu, i cili kryen rolin e mbështetësit emocional të fëmijës gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit, nuk mund të caktohet nga gjykata për të marrë rolin e ekspertit, duke përgatitur vlerësim psikologjik për të njëjtin të mitur”.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit:

Avokati i Popullit vlerëson të sjellë në vëmendjen tuaj zhvillimin e rëndësishëm në legjislacionin shqiptar me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur⁴. Ky kod parashikon një sërë normash që rregullojnë pozitën e të miturve brenda sektorit të drejtësisë penale dhe miraton rregulla dhe procedura specifike të nevojshme për trajtimin e kësaj kategorie të brishtë. KDPM-ja kryesisht ka si qëllim rregullimin e aspekteve të përgjegjësisë penale të fëmijëve që kryejnë vepra penale, por përmban gjithashtu dispozita të rëndësishme në lidhje me fëmijët viktimë të veprave penale. Në fakt, KDPM-ja rregullon çështje të tilla si: pozita e fëmijës viktimë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale; intervistat me fëmijët; masat mbrojtëse gjatë gjithë procesit, në mënyrë që të mos përkeqësohet trauma e tyre; mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve viktimë dhe çështje të ngjashme. Pra, të gjitha aspektet, të cilat janë përmendur dhe janë nxitur të rregullohen nga disa prej instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar⁵.

Vërejmë me shqetësim se lista e dërguar nga “Urdhri i Psikologut” me shkresën nr.4 datë 08.01.2024, nuk i përgjigjet efektivisht thirrjes së strukturave policore për të qenë

⁴ https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/03_Ligj_37_2017_30.03.2017_Kodi_i_Drejtësisë_Penale_për_të_Miturit.pdf

⁵ Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), ratifikuar nga Shqipëria më 27 shkurt 1992;

të pranishëm gjatë procesit të intervistimit të të miturit, në një kohë kur vërejmë se ngjarje ku janë të përfshirë të mitur në cilësinë e të miturit në konflikt me ligjin, viktimë dhe dëshmitar të veprave penale, të cilat janë në rritje.

Theksojmë se nevojitet në mënyrë të menjëhershme rinovimi i listave emërore të psikologëve asistues për të miturit nga Urdhri i Psikologut si dhe një angazhim efektiv të policisë së shtetit në çdo rast të intervistimit të të miturit të sigurojë praninë e psikologut si një garanci themelore në zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

Zbatimi efektiv i Marrëveshjes së bashkëpunimit midis policisë dhe urdhrit të psikologut është një aspekt shumë i rëndësishëm për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të miturve gjatë procesit të hetimeve dhe intervistave të zhvilluara nga autoritetet ligjore, veçanërisht në rastet kur ata janë të përfshirë si viktimë ose dëshmitarë.

Roli i psikologut gjatë intervistës së të miturit në polici është tejet i rëndësishëm dhe ka një ndikim të madh në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe sigurimin e një procesi hetimor të drejtë dhe të sigurt.

Psikologët, veçanërisht **ata që janë të specializuar për të punuar me fëmijët të certifikuar**⁶, luajnë një rol kyç në krijimin e një ambienti ku fëmija mund të shprehet në mënyrë të lirë dhe pa pasur frikë. Intervistat në polici, veçanërisht ato që përfshijnë fëmijë dhe të mitur, mund të jenë stresuese dhe traumatike në vetvete, dhe qëllimi i psikologut është të sigurojë që ky proces të jetë sa më i lehtë dhe më i mbrojtur për ta.

Sigurimi i një ambienti të sigurt dhe mbështetës Psikologu është i detyruar të sigurojë një mjedis që i mundëson të miturit të ndjehet i sigurt dhe i mbrojtur. Ky mjedis është thelbësor për të inkurajuar fëmijën të shprehet lirshëm dhe të ndajë informacionin e nevojshëm për hetimin, pa pasur frikë nga autoritetet ose nga pasoja të mundshme. Krijimi i një atmosfere pa presion, psikologu mund të ndihmojë për të zbutur atmosferën e tensionuar që shpesh mund të krijohet nga prania e oficerëve të policisë.

Standardet ndërkombëtare të harmonizuara në dispozitat kryesore të KDPM-së që zbatohen për fëmijët viktimë të veprave penale janë:

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi i çështjes: parashikon parimin se çdo organ kompetent duhet të shqyrtojë në mënyrë të shpejtë dhe me përparësi çështjet me të mitur viktimë, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar. Duhet të sqarojmë se me autoritete kompetente, përfshihen të gjithë punonjësit të cilët vendosen në kontakt me fëmijën, viktimë, përfshirë gjyqtarin, prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore (ku përfshihet edhe punonjësi i Policisë së

⁶ <https://www.urdhriipsikologut.al/lista-e-eksperteve-te-certifikuar-nga-up-ne-drejttesi/>

Shtetit), avokatin, psikologun, punonjësin social, punonjësin e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (Neni 17).

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut: parashikon se në mënyrë që të mbrohen fëmijët nga trauma, prania e psikologut është e detyrueshme në të gjitha procedurat e ndjekjes penale (hetimi dhe gjykimi). Prania e psikologut është gjithashtu e nevojshme për të siguruar që intervistat me fëmijët të zhvillohen në mënyrën e duhur. Përveç kësaj parashikohet se kur është e mundur, i njëjti psikolog të ndjekë të njëjtin fëmijë viktimë përgjatë gjithë procesit (Neni 18).

Të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturit në konflikt me ligjin: parashikohen në nenet 193 , 20, 23 e 24 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit (falas): parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të miturit, çdo i mitur viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës (Neni 20).

Mbrojtja e jetës private të të miturit: parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të miturit privatësia e fëmijëve duhet të respektohet dhe çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijës viktimë nuk lejohet të publikohet (Neni 21).

Shërbimet pa pagesë për të miturit në sistemin e drejtësisë penale: parashikon se të miturit në konflikt me ligjin ose viktima përfitojnë pa pagesë shërbimet që ofrohen sipas këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi, se pagesat e këtyre shërbimeve mbulohen nga buxheti i institucioneve dhe ekzekutohen nga institucionet përkatëse, pranë të cilave realizohet shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe se procedura e ofrimit të shërbimeve për të miturit në sistemin e drejtësisë penale rregullohet sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Kod (Neni 23).

Mbi të drejtat e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale: parashikohet se i mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale gëzon, për aq sa është e mundur, të njëjtat të drejta të parashikuara për të miturin në konflikt me ligjin, parashikuar sipas këtij kreu, si dhe të drejtat e parashikuara në kreun V të këtij Kodi (Neni 24).

Mbi trajnimin dhe specializimin e autoriteteve kompetente: parashikohet se organet kompetente që punojnë me të miturit duhet të kenë ekspertizën e nevojshme dhe se personat që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të miturit duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ky detyrim përfshin shumë punonjës dhe profesionistë të tillë, si gjyqtarin, prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore (ku përfshihet edhe punonjësi i Policisë së Shtetit), avokatin,

psikologun, punonjës social, punonjës e Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj. (Nenet 25-32).

Specializimi i personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të miturit: parashikohet ndër të tjera, kufizime të personave që punojnë me të miturit dhe përkatësisht në paragrafin 2 përcakton se organet kompetente sigurojnë që çdo person që ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje ndaj të miturit ose për dhunë në familje, ndalohej të punojë me të miturin (Neni 25).

Kompetenca e gjyqësorit të çështjeve të drejtësisë për të miturit: parashikon se brenda gjykatave të rretheve gjyqësore krijohen seksione të posaçme për çështjet e të miturve. Këto seksione janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve/fëmijëve (Neni 27).

Masat mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar: parashikon se në çdo fazë të procesit penal duhet të merren masa të veçanta mbrojtëse për fëmijën viktimë kur siguria e fëmijës është në rrezik. Në varësi të rrethanave këto masa miratohen kryesisht nga gjyqtari (ex-officio), nga prokurori, nga policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Masat mbrojtëse konsistojnë në shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit; bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një “urdhri-kufizimi” në gjykatë; bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg” për të akuzuarin; mbrojtjen e fëmijës prej policisë; masa të tjera të përshtatshme (Neni 37).

Avokati i Popullit si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, kërkon zbatimin efektiv të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Urdhrit të Psikologut si dhe përditësimin e listës emërore të psikologëve asistues/vlerësues përgjatë intervistimit të të miturve.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive".

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për bashkërendimin e punës nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Urdhrit të Psikologut për të

siguruar në mënyrë efektive praninë e detyrueshme të psikologut përgjatë intervistimit të të miturit.

2. Marrjen e masave nga Urdhri i Psikologut për përditësimin e listës emërore të psikologëve asistues/vlerësues përgjatë intervistimit të të miturve në organet e Policisë së Shtetit.
3. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me qëllim njohjen e të drejtave dhe garancive procedurale të të miturit në konflikt me ligjin, viktimës dhe/ose dëshmitarit të veprës penale, të parashikuara në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
4. Marrjen e masave për planifikimin e fondeve për kryerjen e pagesave të psikologëve asistues gjatë procesit të intervistimit të të miturve.
5. Marrjen e masave për të informuar Avokatin e Popullit në vazhdimësi lidhur me ecurinë e këtij procesi nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Urdhri i Psikologut.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v